

Procesverbal
Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar
Mbajtur më datë 28.05.2025

Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:30, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.

Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA m
4. EDMOND KALEMI m
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAUD ZAIMI m
7. ENVER CAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI m
10. MIMOZA HYSAJ
11. MIMOZA ZYLYFTARI
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA

Sekretare e Këshillit deklaroi kuorumin prej 11 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr.15 prot. të datës 20.05.2025.

Kryetare e Këshillit u drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.
Ora 10:35

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Mimiza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 28.04.2025

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 10:40

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Enver Caka, Mimoza Hysaj, Mimiza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë ngaanëtarë e këshilltarët nuk ka shprehur konflikt interesi.

Pika 4 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Prill 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se duhen mikrofonat sepse nuk dëgjohet fare.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili thotë se ka pasur shpenzime të tjera.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se herën e parë u diskutua Panajot Kapallani erdhi për të bërë letrat?

Fjalën e merr znj.Teuta hysenbelliu e cila shpreh se ka bërë aplikimin ka dalë përfitues edhe është me ndihmë ekonomike.Ka dalë nga sistemi në bazë të procedurave bëri aplikimin dhe doli që në muajin prill.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet se sa muaji prapambetës ka?

Fjalën e merr znj.Teuta Hysenbelliu e cila përgjigjet se muaj prapambetës nuk ka, i kanë marrë nga skema, kurse 6% del muaji mars se prillin sot po e kalojmë.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se çfarë është bërë për familjen në Nishicë që është thënë se do ngrihet një grup ekspertësh për ta parë, edhe anëtarë këshilli. Pse spo i kalojnë lekët asaj familje? Kur kanë ardhur nga emergjencat civile, i kanë nxjerr nga shtëpia i kanë dhënë çadër, ju është grisur çadra, i kanë nxjerr me forcë, spo i fusin brenda. Tani ca duhet po i kalojmë 3 milion lekë për të luajtur bixhoz dhe spo i kalojmë një familje që i takon.

Fjalën e merr Kryetare Këshillit nj. Elsa Petritaj e cila shpreh se i ka bërë letrat i ka çuar në bashki dhe ska kaluar këtë muaji.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se merru ti tani mos u merrni me patronazhime merruni me gjëra që u takojnë.

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili shpreh se nuk ka bërë kërkesën.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se si ska bërë kërkesë, thuaj atyre që nuk marrin vesh jo mua që ska bërë kërkesë, kanë ardhur emergjencat civile kanë mbajtur procesverbal i kanë nxjerr nga shtëpia, tani ca kërkesë duhet edhe dokumentat janë bërë. Para zgjedhjeve kaluan 7 -8 ndihma kurse atyre nuk ju kanë kaluar.

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili shpreh se i ka bërë gati Gëzimi.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se ato janë bërë gati që në kohën e Tanit mos thuaj i ka bërë Gëzimi. Pse i kanë bërë dokumentat ata pa bërë ai kërkesën? Thuaj sduan ta bëjnë mos i mbro kot.

Me leje fjalën e merr z. Enver Caka i cili shpreh se do ta bëjnë se kanë vajtur dhe deputetët.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se i takon nuk kanë lidhje deputetët, ka dalë nga fondi emergjencave, deputetët fytyra të reja gënjeshtra të vjetra.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se çfarë kërkon nga ne si këshill, se ne kemi qënë pro.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se si ke qënë pro ti, kur ajo ska ardhur në këshill, nuk kemi hedhur gjë në votim.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se e ke propozuar dhe ne kemi qënë pro për tu bërë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se kam propozuar unë të ngrihet grupi punës të shkoi atje, vajte ti?

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh se nuk ngrihet nga unë grupi punës.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh mos thuaj nuk e ngre unë grupin e punës se ti je përfaqësues i PS-së nuk e ngre grupin por je pjesë e grupit. Mblidhni grupin edhe bëjeni shikojeni.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se janë familje që do ti zënë shtëpitë brenda dhe latë kokrrën e namit.

Kryetare Këshillit drejton pyetje nëse ka diçka në lidhje me ndihmën ekonomike?

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se për mua ndihma ekonomike ka qenë e saktë.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:00

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 5 e rendit të ditës “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Fatos Myftari”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh nqs do kishte ndonjë zgjidhje më të mirë për zotërinë.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se më mirë do ishte ti lidhej diçka muaj për muaj se sa e kalojmë me vendim këshilli njëherë në dy-tre muaj.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:05

Vota pro: 10, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Mimoza Hysaj, Myqerret Hebibasi, Pellumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Të ndryshme

Fjalën e merr z.Pëllumb Guri se ne si bashki marrim ndonjë taksë apo tarifë për këta vizitorët?

Fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se në 2014 kam qenë nënkryetar bashkie dhe e kam propozuar vetë , kam qenë kryetar i buxhetit ka kaluar dhe me vendim këshilli një tarifë 10 euro për çdo kajak dhe 3 euro për person, dhe vinte gati 50 euro për një kajak. Kur ai merte 10 veta fitonte 500 euro dhe 50 euro do liheshin në bashki. U bënë dokumentat të gjitha, u vunë trarët, ai na çoi në gjyq. Pastaj ishte pjesa që e ndihmoi Adnori, Klosin dhe gjyqi u humb. Ai thoshte që vinë 20 mijë turist, edhe merrnin gati 500 mijë euro dhe nuk jepnin në bashki as një lekë.

Fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh shumë shqetësim për turistët që vinë apo këta që bëjnë kanoe, bëjnë veprime të pahijshme. Mendoj se duhet të kënë vende të poshme për tu ndërruar ç'kusur kanë fëmijët të shohin ata kur zhvishen. Në vendet e tjera e zbatojnë pikë për pikë ligjin. Ne skemi asnjë pëfitim nga ata, ushqimin, ujin e të gjitha i marrin me vete po vinë edhe na ndotin këtu. Mendoj se duhen të merren masa sa më parë. Ju lutem kryetare bëjeni sa keni në dorë, t'ju vendoset një tarifë.

Fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se përgjegjësinë për mua duhet ta mbaji ai i rafting, ose të vendosen tualetet portative.

Kryetare e Këshillit e deklaroi përfundimin e mbledhjes .

Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela

Kryetare Këshillit Bashkiak: Elsa Petritaj

Këshilltarët që firmosin procesverbalin:

1.Alma Kadiasi

2.Fikret Telha

3.Skerdilajt Jaupllari